



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1331/3 prot

Datë 09.06.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “4S” SHPK dhe operatori ekonomik “Murati D” SHPK dhe Biotek në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-67235-04-26-2023, me objekt: “*Blerje materiale pastrimi dhe detergjente*” me fond limit 4878534 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
- Ankimues:** BESIM KAMBERI  
*Rruga e Qelqit , Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 – Kashar, Tiranë*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Fier  
Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “4S” SHPK  
Lagjja: Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4, Fier Lushnjë  
Operatori ekonomik “Murati D” SHPK  
Rruga Kavajës, Ish- Kombinati Ushqimor, Godinë 1-katëshe, Tiranë  
Operatori ekonomik “BIOTEK” SHPK  
Rruga: Bashkimi, Nd 3, H1, Vlorë

Në datën 08.06.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1331/2023 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3169 e operatorit ekonomik BESIM KAMBERI për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-67235-04-26-2023, me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjentë” me fond limit 4878534 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 08.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “4S” SHPK dhe operatori ekonomik “Murati D” SHPK dhe Biotek në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Në ankesë ngrihen pretendimet për operatorin ekonomik “4S” SHPK dhe operatorin ekonomik “Murati D” SHPK si më poshtë vijon:

*Nga vleresimi i aturitetit kontraktor na rezulton se operatorët “4 S” dhe “MURATI D” kanë dorezuar oferte anomalisht të ulët. Referuar Pikes 4, Neni 82 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021: Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; - Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.[...].*

Nderkohe autoriteti kontraktor kualifikon gjithashtu operatorin ekonomik Biotek në shkelje të ligjit pasi ky operator ekonomik nuk na rezulton se nuk përmbush piken

*2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se 700 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtme: a- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. ose b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 09.06.2023

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**